



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE

Nr. 1656 / prot.

Tiranë më 02.12.2019

Lënda: Ridërgohet mendim mbi paketën e projektligjit “Për shërbimet e pagesave”

MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË

Tiranë

Në përgjigje të shkresës tuaj nr.18631/6 Prot., datë 25.11.2019, me anë të së cilës ridërgohet për mendim paketa e projektligjit “Për shërbimet e pagesave”, Zyra e Komisionerit ka analizuar argumentet e parashtruara nga Banka e Shqipërisë në cilësinë e institucionit hartues të këtij projektakti.

Sugjerimet e dhëna nga Zyra e Komisionerit me shkresën nr.1656/1 Prot., datë 12.11.2019, për këtë projektligj, janë bërë duke vlerësuar në mënyrë të detajuar procedurat e përpunimit të të dhënave personale, aksesimit, transferimit, masave të sigurisë, garantimit të të drejtave të subjektit të të dhënave, duke u bazuar në parimet e parashikuara në ligjin nr.9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

Duke iu referuar sugjerimeve për të cilat shpreheni se janë marrë në konsideratë nga ana juaj, në draftin e ridërguar, konstatojmë se, në nenin 23, nuk është shtuar paragrafi me përmbajtje: “Të dhënat personale të mbledhura për qëllime të këtij ligji, anonimizohen ose asgjësohen pas përmbushjes së qëllimit të grumbullimit sipas afatit të përcaktuar në këtë nen dhe parimeve të parashikuara në legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale.”, sikurse konfirmohet në shkresën tuaj nr. 18631/6 Prot, datë 25.11.2019, pika 4, paragrafi i dytë.

Me reflektimin e këtij sugjerimi në projektligj, projektakti vlerësohet i hartuar konform ligjit nr. 9887/2008 ‘Për mbrojtjen e të dhënave personale’, i ndryshuar.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

